



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice-Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPSDPLS.nr.20/2025

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga në përbërje nga Naim Mehulli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Driton Govori, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj Përmbarueses Private si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr.4678/25, P.nr.5837/25, P.nr.5284/25, P.nr.4607/25, P.nr.5766/25, P.nr.5213/25, P.nr.2970/25, P.nr.4135/25, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Politika të sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika - Divizioni për Profesione të Lira dhe Statistika, Burbuqe Spahija Kerveshi, Përmbaruesi Privat dhe përfaqësuese e palës ankuese-Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Përmbarueseve Privat, me datë 15.12.2025, mori

V E N D I M

Organi përmbarues - Përmbaruesi Privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në është përgjegjës për shkelje disiplinore, tejkalim i autorizimit të besuar me ligj, ashtu që të njëjtit i shqiptohet masa disiplinore, gjobë në të holla, në shumën prej 2,000.00 euro (dymijë euro), të cilën detyrohet të paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, në llogarinë e Buxhetit të Odës së Përmbaruesve, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Divizioni Për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira me datë 27.10.2025, ka parashtruar raportin e inspektimit të kryer ndaj përmbaruesi privat me konstatimin dhe pretendimin se përmbaruesi privat ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën

Përmbarrimore, pasi nga raporti i inspektimit të rregullt që i është bërë përmbarruesit, është konstatuar se përmbarruesi privat ka bërë shkelje, duke tejkaluar autorizimet e tij ashtu që fillimisht lejimin e përmbarrimit e ka bërë për lëndet P.nr.4678/25, P.nr.5837/25, P.nr.5284/25 e të tri lëndet janë me të njëjtin dokument përmbarrimor Marrëveshja e Ndërmjetësimit Nr.1233/2025 dt.22.05.2025, për të gjitha këto lënd janë përqasur nga i njëjti avokat i cili i ka paraqitur tri propozime ku dy prej tyre në të njëjtën datë 17.06.2025, krijimi i tri lendeve për të njëjtin debitor dhe në të njëjtën datë ka shkaktuar kosto të panevojshme buxhetit publik, po ashtu në dokumentin përmbarrimor nuk është cekur afati i ekzekutimit. Përmbarruesi në situat të njëjti ka vepruar edhe në lëndet e tjera të verifikuara gjatë inspektimit dhe atë në lëndet P.nr.4607/25, P.nr.5766/25, P.nr.5213/25, P.nr.2970/25, P.nr.4135/25. Divizioni i lartcekur ka propozuar komisionin që të aprovohet ankesa dhe të ndermirren masa ndaj përmbarruesit privat. Në seancën dëgjimore të datës 15.12.2025 përfaqësuesja e këtij divizion ka deklaruar se mbetet në tersi pran këtij raport duke propozuar që ndaj përmbarruesit të veprohet konfirm legjislacionit në fuqi.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, me datë 27.10.2025, ka paraqitur në Komision Disiplinor Raportin Përfundimtar, ndaj përmbarruesit private, si organ përmbarrues, lidhur me veprimet e ndërmarra nga përmbarruesi privat në lëndën përmbarrimore P.nr.4678/25, P.nr.5837/25, P.nr.5284/25, P.nr.4607/25, P.nr.5766/25, P.nr.5213/25, P.nr.2970/25, P.nr.4135/25, me propozim që të ndërmerren veprimet e nevojshme lidhur me këtë rast. Po ashtu në seancën e dt.15.12.2025 ka mbetur në tërësi pran këtij raport dhe ka kërkuar të merret vendim meritor për këtë çështje.

Përmbarruesi Privat, në seancën dëgjimore të datës 15.12.2025, ka deklaruar se nuk e ndien veten përgjegjëse për asnjë nga veprimet e ndërmarra përmbarrimore në këtë rast duke shtuar se raporti i Ministrisë së Drejtësisë për iniciimin e kësaj procedure mendoj që duhet të refuzohet në tërësi si i pa bazuar për arsye se sipas këtij raporti kemi të bëjmë ekskluzivisht me kompetencën e lejimit të përmbarrimit e cila kompetence është ekskluzivisht e bazuar në nenin 71, paragrafi 1 nën paragrafi 12 i LPP dhe nuk është kompetence e këtij komisioni, prandaj konsiderojmë që kjo shkelje nën të lartcekur nga ana ankuese. Për këtë unë i kom dy vendime të komisionit disiplinor në rastet e me hershme të ngjashme që i dorëzoj si prova ku vet ky komision ka ardh në këtë përfundim. Ky vendim thotë që: Komisioni nuk është kompetente për këtë çështje andaj kërkojmë që të mos shqyrtohet ky raport, dhe se dyti: Përmbarruesi nuk i ndan lëndet, përmbarruesi është institucion që e zbaton përmbarrimin, lëndet përmbarruesi ka të drejt ti lejoj apo ti refuzoj propozimet që i sjelle pala kreditore. Propozimet nuk i kom nda unë, nuk i ndan përmbarruesi. Në si përmbarrues kemi të drejt ti lejojmë apo ti refuzojmë dhe nuk i komentojmë gjerat e tjera që jone jashtë kompetencës

tone. Tjetra raporti i Ministrisë, nuk e ka asnjë reference ligjore. Ne baze të cilën dispozitë thesari ka të drejt të ankohej ndaj një vendimi të formës së prere. Thesari ka obligim që brenda një ore me ekzekutua, përgjegjësi i bien përmbartuesit sipas LPP. I ka propozuar komisionit që të refuzohet ankesa.

Komisioni Disiplinor me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbartuesi privat, ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe provave të administruara, vlerëson se përmbartuesi privat, në rastet konkrete me numra P.nr.4678/25, P.nr.5837/25, P.nr.5284/25, P.nr.4607/25, P.nr.5766/25, P.nr.5213/25, P.nr.2970/25 dhe P.nr.4135/25, ka tejkaluar autorizimet e tij ligjore gjatë caktimit dhe lejimit të përmbartimit.

Nga shkresat e lëndës rezulton se përmbartuesi privat ka lejuar propozime për përmbartim ku si kreditorë janë paraqitur _____, ndonëse të njëjtit nuk kanë qenë palë në procedurë, respektivisht nuk kanë qenë palë në dokumentin përmbartues – “Marrëveshjen e Ndërmjetësimit”.

Komisioni vëren se nga përmbajtja e dokumentit përmbartues, konkretisht nga dispozitivi i “Marrëveshjes së Ndërmjetësimit”, rezulton qartë se detyrimi i debitorit ka qenë i përcaktuar vetëm ndaj palës që ka arritur marrëveshjen e ndërmjetësimit, si për kërkesën kryesore ashtu edhe për kërkesat aksesore. Në asnjë pjesë të marrëveshjes nuk është përcaktuar se ndërmjetësuesi apo ekspertit kanë të drejtë të paraqiten si palë kreditore ose përfitues të drejtpërdrejtë të detyrimit.

Pavarësisht kësaj gjendjeje faktike dhe juridike, përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin sipas kërkesës së të autorizuarit të kreditorit, duke e aprovuar propozimin për përmbartim edhe në emër të ndërmjetësuesit dhe ekspertit, megjithëse ka qenë apo është dashur të jetë i vetëdijshëm se të njëjtit nuk janë palë në dokumentin përmbartues. Një veprim i tillë përbën tejkalim të kompetencave ligjore dhe cenim të parimit të ligjshmërisë në procedurën përmbartimore.

Për më tepër, Komisioni vlerëson se në këtë rast përmbartuesi privat nuk i ka kushtuar vëmendjen e nevojshme mbrojtjes së dinjitetit të debitorit, ashtu siç parashihet me nenin 9 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP). Lejimi i përmbartimit mbi bazën e një dokumenti përmbartues përmes tri propozimeve të ndara për përmbartim, përfshirë edhe dy persona që nuk janë palë në

dokumentin përmbarues, i ka shkaktuar dëm debitorit dhe ka rënduar në mënyrë të pajustificuar pozitën e tij juridike në përmbushjen e detyrimit.

Në këto rrethana, Komisioni Disiplinor vlerëson se veprimet e përmbaruesit privat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe përbëjnë shkelje të nenit 367 paragrafi 1, nënparagrafi 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor mori parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht faktin peshën e dëmit të shkaktuar ndaj palës debitore, e cila ka ndikuar në lartësinë e masës së shqiptuar. Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar me gjobë në të holla bazuar në nenin 368 paragrafi 1 nën paragrafi 3 i LPP-së, i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve të përmbarimore, të përmbaruesit privat si dhe tek përmbaruesit tjerë privat që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka në thelb, është edhe qëllimi i masës. Ndërsa, detyrimi se ku duhet të bëhet pagesa e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi, u bazua në nenin 11, të LIGJIT, NR. 08/L-102 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 05/L-118, përcaktohet se: "*Neni 368 i ligjit bazik, paragrafi 3, togfjalëshi "në buxhetin e Republikës së Kosovës", ndryshohen me togfjalëshin "në buxhetin e Odës së Përmbaruesve", andaj gjoba e shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi duhet të paguhet në llogarinë e buxhetit të Odës së Përmbaruesve*

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPSDPLS.nr 20/2025 datë 15.12.2025

Kryesues i Komisionit Disiplinor

Naim Mehulli



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.